

INSPEKTORATI QENDROR I PUNËS
Centralna Inspektorat Rada / Central Labour Inspectorate

Nr. Jb. No. 90 Nr. Prot. Dren. No. pp. 2
Data/Orari/Pun. 26.01.26

PRISHTINË, KOSOVA, PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Inspektorati Qendror i Punës/Centralna Inspektorat Rada/ Central Labour Inspectorate



01Nr.1305-09/2026-V

Inspektori i Punës në Inspektoratin Qendror të Punës në regjionin e Prishtinës [REDACTED], i autorizuar sipas nenit 82 dhe 94 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, dhe Ligjit Nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, nenit 38 dhe 39 të Ligjit nr.08/l-067 për Inspektimet, konform ankesës së parashtruar në Inspektoratin Qendror të Punës, e protokoluuar me datë 13.01.2026, dhe me nr.prot.12, nga [REDACTED] e përfaqësuar nga avokati z. Avokat [REDACTED] kundër punëdhënësit Komuna – Fushë Kosovë, lidhur me vendimin nr.2457, dt.12.12.2025, me datë: 26.01.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Inspektorati Qendror i Punës është **JO KOMPETENT** lidhur me ankesën e palës ankuese [REDACTED] kundër punëdhënësit Komuna Fushë Kosovë, lidhur me vendimin nr.2457, dt.12.12.2025
- II. Përfundohet procedimi administrativ në shkall të parë të Inspektoratit Qendror të Punës i filluar sipas ankesës së protokoluuar në IQP me datë 13.01.2026, dhe me nr.prot.12, nga [REDACTED] kundër punëdhënësit Komuna Fushë Kosovë

Arsyetim

Inspektori i Punës ka pranuar ankesën e parashtruar në Inspektoratin Qendrorë të Punës, e protokoluuar me datë 13.01.2025, dhe me nr.prot.12, nga Pranvera Llugiqi Pacolli, lidhur me vendimin nr.2457, dt.12.12.2025.

Inspektori i Punës bazuar në pretendimet ankimore të palës ankuese, me rastin e trajtimit të lëndës nuk ka gjetur bazë ligjore për të trajtuar ankesën për shkak se Inspektorati Qendror i Punës nuk ka kompetencë të trajtoj pranimin e punonjëseve dhe marrdhëniet e punës të cilat rregullohen me ligje të veçanta, e që në rastin konkret, marrdhënia e punës për të cilën është ankuar ankuesja rregullohet me Ligjin NR.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Për më tepër, në nenin 5, paragrafi 2, të Ligjin NR.08/L-197 për Zyrtarët Publik është përcaktuar se, “Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i

i shërbimit publik është edhe nëpunësj/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës". Si dhe aktet nënligjore përkatëse sipas nenit 103 të këtij ligji.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë, çështja duhet t'i drejtohet organeve kompetente.

Pra, Inspektorati Qendror i Punës nuk ka kompetencë të trajtoj ankesën e palës ankuese [redacted]

Prandaj, në bazë të rrethanave të theksuara më lartë, u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim është përpiluar në kopje të mjaftueshme identike nga një 1 kopje i dorëzohet palëve në procedurë, ndërsa kopjet tjera Inspektorët e Punës i mbajnë për procedurë të mëtejshme.

Inspektori i Punës

[redacted]
[signature]

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi lejohet ankesë në afat prej 30 ditësh, në Komisionin e Ankesave të Inspektoratit Qendror të Punës, nëpërmes Inspektoratit Qendror të Punës në Prishtinë, "Objekti Qendra Tranzite Postare, Zona Industriale, magjistralja Prishtinë – Fushë Kosovë".